



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 607/L Prot

Fushë-Arrëz më, _____/2024

P/VENDIM

Nr. 31 datë _____2024

**“PËR
DHËNIE E DAKORDËSISË PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË NJË SIPËRFAQJE
PYJORE PUBLIKE PREJ 0.0719 HA PËR; KANALIN E LINJES SË UJIT NË
TERRITËRIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ PËR SHOQERINË “UJI PUKA” SH.P.K
NË ZONEN KADRASTALE ME NR.1657 DHE NR.2686, NË TERRITËRIN
ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, pika e ; Ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet” ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” ; VKM-në nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” ; Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, si dhe referuar raportit tekniko-ekonomik të hartuar nga Specialistat e Drejtorisë Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pas depozitimit të dosjes teknike me dokumentacionin sipas Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016;

- I propozojmë Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz; Dhënie e dakordesinë për dhënie në përdorim të një sipërfaqje pyjore publike prej 0.0719 ha për; Kanal in e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për Shoqerinë “UJI PUKA” Sh.p.k në zonen kadastrale me nr.1657 dhe nr.2686 në territorin administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz.
- Pas miratimit të dakordesinë nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave do të vazhdojnë procedurat për lidhjen e kontrates së qerasë me subjektin.
- Bashkëlidhur këtëj Projekt – Vendimi është relacioni shprehues dhe lista e ngastrave/nëngastrave pyjore që kalon gjurma e kanalit të ujit në territorin administrative të bashkisë Fushë-Arrëz.

DREJTORI I ADM PYJEVE DHE KULLOTAVE

Ardmir Doda



JURISTI
Redona Hasani



KRYETARI

Hil Curri



KRYETARI I KESHILLIT

Nikolin Bardhoku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE



Fushë-Arrëz, më 24.10.2024

RELACOIN

(Mbi kanalin e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për Shoqerine "Uji Puka" Sh.p.k)

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54, pika e ; Ligjin nr.57/2020 "Për Pyjet" ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" ; VKM-në nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore" ; Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", si dhe referuar raportit tekniko-ekonomik të hartuar nga Specialistat e Drejtorisë Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pas depozitimit të dosjes teknike me dokumentacionin sipas Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016; si dhe referuar kërkeses së Shoqerisë "UJI PUKA" Sh.p.k date 27.09.2024.

Bashkia Fushë-Arrëz në zbatim të Udhezimit nr.1 date 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" Pika.24, ka ngritur grupin e punës me Urdherin e Kryetarit të Bashkisë nr.552 date 01.10.2024 "Për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik me objekt: "Kanalini e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz" nga Shoqeria "UJI PUKA" Sh.p.k me Administrator z.Kel Gjinaj.

Dosja e sjelle nga Shoqeria "UJI PUKA" Sh.p.k ka këto dokumenta:

Nr.	Titulli i Dokumentit	Dokument i plotësuar sipas Udhezimit nr.1 date 09.06.2016	Shenim
1	Kërkesa nga Subjekti "Uji Puka" Sh.p.k	Po	
2	Vendim nr.12 datë 15.07.2024 nga Keshilli i Bazenit Ujor Mat		
3	Leje për përdorimi burimi ujor nëntoksor nr.11 date 26.07.2024 nga Këshilli i Bazenit Ujor Mat	Po	
4	Projektin Teknik dhe Grafikiun e punimeve	Po	
5	Harten Topografike në shkallen 1:10 000	Po	
4	VNM	Po	
5	QKR	Po	

Bazuar ne Udhezimi nr.1 date 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", *Pika nr.22 "Bëjnë përjashtim nga Konkurrimi publik dhënja e sipërfaqeve në përdorim rastet kur persona fizik/juridik janë të pajisur me leje/licence nga insitucionet përkatëse për veprimtarite që kanë të bëjnë me:*

Pika. e) procedurat në zbatim të ligjit për përdorimin e ujërave;

Referuar Udhezimi nr.1 date 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënle në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pasi subjekti plotëson *Pika.24* vazhdohet me zbatimin e *Pikës nr.25 e këtij Udhezimi "Për hartimin dhe studimin në terren të Raportiti Tekniko-Ekonomik mbi sipërfaqen objekt i aktivitetit.*

Drejtoria e Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave ka hartuar Raportin mbi Studimin Tekniko-Ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publik të bashkisë Fushë-Arrëz për kanalën e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për Shoqerine "Uji Puka" Sh.p.k.

Një kopje e Raportit Tekniko-Ekonomik është dërguar në Këshillin Bashkiak me Shkresë nr.3122 prot datë 11.10.2024 "Dërgim i Raportit Tekniko-Ekonomik për Subjektin "Uji Puka"Sh.p.k me objekt: Kanalin e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Në Udhezimin nr.1 date 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", *Pika.26 Kryetari i Bashkisë miraton Studimin Tekniko-Ekonomik të hartuar nga DAPK*

dhe lidh Kontraten e Qirasë të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor brenda një afati 20 ditëve punë.


Në zbatim të ligjit nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" neni.54 pika.e "Për tjetërsim dhe dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor kërkohet dakordesia e Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz për dhënie në përdorim të fondit pyjor.

Pas miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak do te vazhdojë procedura per lidhjen e kontrates se qease sipas Udhezimin nr.1 date 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Pika.26.

Bazuar në relacionin e mësipërm paraqesim Projekt-Vendimin.


Drejtori

Ardmir Doda



Juristi

Redona Hasani



Kryetari

Hil Curri

